

**KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL  
SH.A.**



Zyret qendrore  
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355  
[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)

**REGULLORE PËR SISTEMIM DHE PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS**

**KRU"HIKRODRINI"SH. A. - PEJË**

**Regullore për Sistemim apo ndryshimet per arsyeje te ritjes se efikasitetit, eshte mjeti me te cilen mund te arijme qe caqet tona te permbushen. (Pershkrimi i Vendeve të Punës)**

Problemet ekzistuese:

1. Pergjegjësia nuk nuk eshte detajuar dhe se disa punetore jane me te angazhuar se puntoret tjere, ne departamente sektor, pergjegjësia nuk eshte kuptuar dhe skjaruar.
2. Delegimi i detyrave dhe informimit i vjeter dhe jo shume funksional,
3. Kemi raste kur ngatrohesh raportimi, apo raportohesh ne vendin e gabuar,
4. Ne disa sektor mund te implementohesh performanca per punen e kryer,
5. Punetoreve nuk i eshte skjaruar apo shpjeguar pershkrimi i puneve ( ku pastoj pershkrimi nuk mirret seriozisht).

Qellimi i riorganizimit eshte:

1. Që te ngritet shkalla e pergjegjësise dhe te ritet efikasiteti,
2. Që secili punetore ti di punet sipas pershkrimit dhe kontrates,
3. Që secili departament, sektor te kete pergjegjësine e caktuar,
4. Që raportimet te kjarsohen dhe te delegohen sipas rendit,
5. Që ne kompani te krijojme frymen e gares.

Problemet e ndara:

1. Problemet Operative ne furnizim me ujë dhe kanalizim dhe sisteme te pmpimit.

- *Ekipe duhet qart te definohen dhe te ndahen me emra, nganjehere formohen aty per aty.*
- *Raportimi i puneve te riparimeve te thjeshtohet dhe per riparime te kete kriter,*
- *Kualiteti i punimeve jo adekuat, kemi raste kur ne nje riparim intervenohet me shum se njehere,*
- *Pas riparimeve kemi raste kur gjendja nuk kethehet ne gjendjen para riparimit, pra nuk pastrohet dhe sigurohet,*
- *Ne kanalizim eshte rast i njejetë, por shpresojme se me investimet nga Gjermanet puntoret e ketij sektori do te trajnohen dhe pajisen me pajisje te pastrimit.*
- *Sistemet e pompimit nuk kane mirembajtje të mirefillet, si dhe raportimi behet vetem per pompa kryesore,*
- *Kemi raste kur meprishjen e ndonje pompe nuk ka kordinim dhe njoftimi nuk behet sipas pergjegjesisë.*

2. Sherbimi me konsumatorë:

- *Faturimi dhe Inkasimi nga inkasuesit duhet te analizohet dhe te jet nje pergjegjes per percjedhjen e faturimeve, pra duhet te analizohen te percidhen gjendjet institucionet, bizneset, etj, pra faturimi si dhe te behet kontrolla e leximeve,*
- *Inkasuesit te ndahen ne zona, si dhe te shtohet numri i Inkasanteve, minimum per 5 vetem ne Pejë, kemi raste ku nje inkasues ka me shume se 1500 konsumatorë,*
- *Si problem tjetër eshte edhe familjarizimi me Inkasues, pra nuk ka pasur ndryshime asnjehere, pra duhet te regrutohet nje person i cili kishte me percjedh gjendjen e tyre,*
- *Ekipi i shkyçjeve per mos pages, duhet te caktohet nje person i cili do ti orientonte, apo te cakton pikat se ku do te vepron ekipi i shkyçjeve,*

3. Sherbimi i GIS,

- *Te caktohet qart, puna si dhe kriteret e performances, se sa konsumator duhet te rexhistorjnë,*
- *Te dhenat e GIS-it, nuk shfrytezohen, si nga ana operative ashtu edhe nga ana e sherbimit me konsumatorë,*
- *Ekipi duhet te veproj ne tere rajonin e Hidrodrinit,*

4. Sherbimi i Kualitetit te Ujitë:

- Në sotë kemi laboratorin ku kemi vetëm një kimist të diplomuar, për teste të brendshme të ujitë, laboratori është i pajisur me mjete, laboratorike, por nuk plotëson të gjitha standardet e përcaktuara, për funksionalizimin e laboratorit duhet edhe shtimi i personelit, pra vetëm me një laborante nuk mund të udhëhiqet ky sektor,

Ke të jave disa probleme me të cilat, me implementimin e një riorganizimi mund dukshëm të përmirësojmë gjendjen dhe performancën e kompanisë.

## **Metodologjia e Riorganizimit**

### **Bordi i drejtorëve**

Me procesin e korporatizimit të kompanive publike në Kosovë, dhe bazuar në statutin e KRU "Hidrodrini" Sh. A organi drejtues i kompanisë është Bordi i drejtorëve. Synimi kryesor dhe më i rëndësishëm i bordit të drejtorëve është për të siguruar transparencë, besueshmëri dhe rritje të cilësisë në punë.

### **Kryeshefi Ekzekutiv**

KE do të jetë kryezyrtari ekzekutiv i kompanisë. Ai do të ketë kompetencën të lidhë kontrata në emër të kompanisë, në përputhje me statutin, këto akte nënligjore dhe ligjin e Zbatueshëm, dhe e raporton Bordin e Drejtorëve.

Veprimtaritë ditore të kompanisë kryhen nën menaxhimin dhe mbikëqyrjen e KE në përputhje me statutin dhe këto akte nënligjore të kompanisë si dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve.

KE do të kryejë të gjitha detyrat e tjera që janë caktuar nga BD-ve.

### **Departamenti Financiar**

Departamenti financiar do të bëjë menagjimin e mjeteve financiare ashtu siq parashifet me politikën e kompanisë, kompenzimet ndaj punëtorëve, kryerja e detyrimeve ndaj furnitorëve, pagesat për administratën tatimore, ZRRUM-in, MMPH do të bëhen konform rregullativit përkatës, do ti aplikohen në kontabilitet Standartet e Kontabilitetit të Kosovës.

Kontabiliteti qendror udhëhiqet në Pejë, ndërsa faturimi bëhet në Istog, Klinë, Junik dhe Deçan në mënyrë që informatat më të freskëta të jenë sa më afër konsumatorëve.

### **Departamenti për Shërbime të Konsumatorëve**

Departamentit për Shërbime të Konsumatorit (SHK) bene organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Siguroj përformancë të mirë të shërbimeve për publikun, siguroj komunikimin me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallen e inkasimit. Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhrit. Organizon punën e ekipeve të inspektionit, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe serioze. Merret me kërkesat për kyçe të reja, përgatitë dokumentacionin dhe I dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.

### **Departamenti i Administrates.**

Ky Departament është i orientuar të kryej shërbime për te gjitha pjesët sa i përket administrimit dhe shërbimeve te përgjithshme të cilat i nevojiten tere kompanisë. Ky Departament merret me Burimet Njerëzore, Këshilla Ligjore, Mbrojtje dhe siguria, zhvillon Rregullore te brendshme si dhe procedon dhe monitoron implementimin e tyre, jep propozime dhe implementon masa për përmirësimin e identitetit te përbashkët të të gjithë fuqisë punëtore. Si dhe siguron nënshkrimin e marrëveshjeve mes komunave dhe kompanisë dhe kontratave te ndryshme. Ne kuader te ketij departamenti eshte edhe sigurimi i objektit administrativ dhe sigurimi ne pune.

## **Njesitë Operative**

Hidrodrini ka 5 Njesi Operative, Peja, Istogu, Deçani, Klina dhe Juniku, pasi qe zyret kryesore janë ne Pejë dhe Hidrodrini duhet të veproj sipas standardeve evropiane dhe konform rregullave te percaktuara me Ligjin mbi Ndermarrjet publike dhe ARRU-së, ku kem i standardet mbi sherbimet te cilat duhen te plotsohen, pra se çka duhet kompania te siguroj, cilat sektore apo sherbime ashtu qe pergjegjesia te percaktohet sipas ligjeve që jane ne fuçi.


Njësit Teknike Operative jane pergjegjese per (Mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellsit dhe kanalizimit, Mirëmbajtja e mekanizimit dhe pompave, Infrastrukturën e sistemit te ujësjellsit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e ujësjellësve rural), si dhe ne njesite operative Istog, Kline dhe Junik per shkake te pozites gjeografike kane pergjithesi te implementimit te politikave tek sektoret e shitjes.


Menaxheret e njesive operativ do te kene pergjithesi ne punen e sektoreve te cilat udheheqin dhe ne veçanti do te vlersohet puna e tyre ne implementimin e vendimeve dhe detyrave qe parashtrohen nga KE.

## **Raportimi**


Raportimi mujor do te hartohet, sipas Riorganizimit të Ri , të aprovuar nga BtD.

## Skema Organizative – KRU Hidrodrini (2021, 2022)







33, me 8.567 kons. (260)










19, me 4.616 kons. (243)






25, me 5.932 kons.(237)





4, me 1.327 kons. (331)



## **Anëtari I Ekipit të Shkycjes**

Anëtari I Ekipit të Shkycjes (AESH) do të I raportojë direkt Kryesuesit të Departamentit të Shërbimeve për Konsumatorin (KiD).

Ai/Ajo do ti kryej detyrat /punët e tij/saj të shkycjes dhe rikycjeve sikur I udhëzuar nga KiD. Ai/Ajo gjithashtu luan rol të rëndësishëm në marrëdhëniet me publikun dhe funksionon si ndërlidhje e rëndësishme për konsumatorin.

### **Detyrat e Anëtarit të Ekipit të Shkycjes janë:**

- Kryen detyrat e tij/saj të shkycjes dhe rikycjes në mënyrë korrekte dhe me kohë sikur i/e udhëzuar nga KiD.
- Të jetë I mirë informuar rreth rregulloreve dhe çdo çështje sa I përket furnizimit me ujë në zonën respective.
- Raporton çdo parregullsi.
- Përfaqëson Hidrodrinin tek konsumatorët dhe publiku dhe kryen detyrën e tij/saj në mënyrë të orientuar nga konsumatori.

### **Më detajisht kjo përfshin:**

- Shkyç konsumatorët sikur I udhëzuar nga KiD.
- Kontrollon gjendjen e konsumatorëve të kyçeve dhe shkycjeve sikur I udhëzuar nga KiD .
- Rikyq konsumatorët pasi ndërprerjes së arsyes për shkycje dhe sikur I udhëzuar nga KiD.
- Mbështet rregjistrimin e kyçeve shtëpiake të inspektuara nga ekipi I Blok Mappingut.
- Raporton aktivitetet dhe rezultatet ditore tek KiD në përputhje me orarin.
- Siguron sqarime sipas kërkesës rreth rasteve të ndryshme.
- Në ekzekutimin e detyrave të lartcekura, AESH gjithashtu do të hetoj, vëzhgoj dhe raportoj tek KiD:
  - Çdo defekt apo dëmtim në instalimin e ujëmatësve.
  - Çdo përdorim të dukshëm të ujit të pa matur të konsumatori (kycje ilegale).

- Çdo keqpërdorim të dukshëm të ujit të furnizuar nga Hidrodrini.
- Çdo rrjedh apo dëmtim të pajisjeve / pronës së Hidrodrinit, përfshirë çdo gjë që mund të ndërhyj në integritetin e sistemit të rrjetit.
- Këshillon konsumatorët për legalizimin e kyçeve të paregjistruara.
- Kuptoj kontratën e furnizimit me ujë.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

## **ESKAVATORISTI.....(1.5)**

(Departamenti i Mirëmbajtjes dhe Riparimeve)

Ekskavatoristi është nomenklature e Departamentit të Mirëmbajtjes dhe Riparimeve raporton të Përgjegjësi i Sektorit dhe është përgjegjës për detyrat e përditshme të drejtimit dhe punimeve që kryen me automjetin e tij

Detyrat e ekskavatoristit janë:

- Te operoje pajisjen gërmese në përputhje me normat teknike në fuqi dhe me rekomandimet e prodhuesit.
- Te kryejë në kohë e me cilësi detyrat që i ngarkohen
- Te mos përdore në asnjë rast mjetin pa urdhër të eproreve, për punë personale apo që dëmtojnë interesat e Kompanisë. Në rast të kundërt mban përgjegjësi dhe ndaj tij mund të merren masa disiplinore
- Te kujdeset për mirëmbajtjen e mjetit veçanërisht nga pikëpamja teknike

- Te kryeje ne kohe shërbimet e zakonshme dhe për çdo problem te njoftoje Përgjegjës të Sektorit
- Te raportoje çdo defekt apo shërbim që kryen mjetit tek Përgjegjësi i Sektorit nga i cili varet.
- Regjistroj të gjitha lëvizjet e kryera si dhe karburantin dhe vajin e përdorur, në 'ditarin e makinës'.
- Mirëmban pajisjet e specializuara sipas rekomandimeve të prodhuesit
- Mban vendin e punës të pastër dhe të rregullt.
- Është përgjegjës për disiplinën në punë bazuar në kodin e punës, dhe është përgjegjës për sigurinë e punëtorëve dhe publikut.
- Është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur të makinerive, pajisjeve dhe veglave të Kompanisë.
- Regjistroj të gjitha veprimet në 'fletën e punës' së bashku me kohën e realizimit dhe materialet e përdorura.

Nën përgjithësinë : Përgjegjësi i Sektorit / Menaxheri Operativë

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendshme:**

## **Ndihmese administrative / pastruese .....(1.6)**

(Departamenti i Teknik)

Pastruesja/ ndihmese admin. është nomenklature e Departamentit te Teknik raporton te Përgjegjësi i Sektorit të furnizimit me Ujë dhe është përgjegjës për detyrat e përditshme te drejtimit dhe punimeve qe kryen në Departamentin Teknik.

Detyrat dhe përgjithësitë janë:

- Të beje pastrimin e të gjitha zyrave të objektit.
- Të raportoj te Përgjegjësi i sektorit të furnizimit me ujë.
- Është përgjegjëse për pastërtinë e objektit.
- Shërben stafin udhëheqës me kafe te mëngjesit sipas delegimit të Përgjegjësit të Sektorit të furnizimit me ujë.
- Kryen të gjitha punët e parashtruara nga Përgjegjësi i Sektorit të furnizimit.
- Ndihmon Përgjegjësin e Sektorit të furnizimit me ujë ne shkresa dhe disa punë administrative (evidentimi i të dhënave ne kompjuter)
- Është përgjegjëse për siguri ne punë dhe sigurimin e mjeteve materiale që janë nen përgjithësinë e saj (biffeja).
- Te zbatoje me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën ne pune dhe zbatimin e detyrave te ngarkuara.
- Te mos kundërshtoje dhe zbatoje, brenda kritereve te caktuara, te gjitha detyrat ditore qe mund ti ngarkohen nga Përgjegjësi i Sektorit të furnizimit me Ujë, brenda profesionit te tij, duke raportuar për realizimin e tyre para eprorit qe i ngarkon këtë detyre konkrete.

Nen përgjithësinë : Përgjegjësi i Sektorit / Menaxheri Operativë

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendeshme:**

## Inspektorët

Inspektori do të I raportojë direkt Kryesuesit të Departamentit të Shërbimeve për Konsumatorin (KiD).

Ai/Ajo do ti kryej detyrat /punët e tij/saj të inspektimeve dhe kontrollit sikur I udhëzuar nga KiD. Ai/Ajo gjithashtu luan rol të rëndësishëm në marrëdhëniet me publikun dhe funksionon si ndërlidhje e rëndësishme për konsumatorin.

### Detyrat e inspektorëve janë:

- Kryen detyrat e tij/saj në mënyrë korrekte dhe me kohë sikur i/e udhëzuar nga KiD.
- Të jetë I mirë informuar rreth rregulloreve dhe çdo çështje sa I përket furnizimit me ujë në zonën respektive.
- Raporton çdo parregullsi.
- Përfaqëson Hidrodrinin tek konsumatorët dhe publiku dhe kryen detyrën e tij/saj në mënyrë të orientuar nga konsumatori.

### Më detajisht kjo përfshin:

- Kontrollon leximet e ujëmatësve të lexuesve të ujëmatësve.
- Verifikon leximin faktik të ujëmatësve të konsumatorëve.
- Heton dhe komenton arsyet për lexime të pazakonta të ujëmatësve.
- Heton kyçje shtëpiake në mënyrë që të gjej dhe përcaktoj kyçje ilegale.
- Këshillon konsumatorët në legalizimin e kyçeve të paregjistruara.
- Mbështet regjistrimin e kyçeve shtëpiake të inspektuara nga ekipi I Blok Mappingut.
- Dorëzon të gjeturat dhe rezultatet ditore tek KiD në përputhje me orarin.
- Siguron sqarime sipas kërkesës rreth rasteve të ndryshme.
- Në ekzekutimin e detyrave të lartcekura, Inspektori gjithashtu do të hetoj, vëzhgoj dhe raportoj tek KiD:
  - Çdo defekt apo dëmtim në instalimin e ujëmatëseve.



- Çdo përdorim të dukshëm të ujit të pa matur të konsumatori (kyqjet ilegale).
- Çdo keqpërdorim të dukshëm të ujit të furnizuar nga Hidrodrini.
- Çdo rrjedh apo dëmtim të pajisjeve / pronës së Hidrodrinit, përfshirë çdo gjë që mund të ndërhyj në integritetin e sistemit të rrjetit.
- Kuptoj kontratën e furnizimit me ujë.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

## **KLORINUESI**

Klorinuesi është nomenklature e Departamentit të prodhimit të ujit, raporton të Kreu i Departamentit dhe është përgjegjës për klorinimin e ujit të pijshëm në pikat e klorinimit. Disinfektimi i ujit të pijshëm është një mase mbrojtëse nga sëmundjet epidemike të popullatës, prandaj personeli që merret me disinfektimin e tij duhet të jetë i ndërgjegjshëm në kryerjen e detyrës dhe të zbatojë me korrektësi e seriozitet të gjitha kriteret e caktuara në realizimin e kësaj detyre.

Në këtë detyre lejohen të punojnë vetëm personat e aprovuar nga Drejtoria e Kompanisë që janë të pajisur me dëshmi aftësie, të lëshuar nga përgjegjësi i laboratorit të Kompanisë. Nuk lejohen të jenë prezent gjatë procesit të klorinimit persona të jashtëm të paautorizuar dhe nuk lejohet të punojnë në këtë proces pune punonjës nën moshën 16 vjeç, gra apo persona që kanë plage në duar, fytyrë ose që janë me raport mjekësor, në baze të cilit ndalohet të punojnë në këtë vend pune.

Instrukcioni i punonjësve që do të merren me përdorimin e administrimit të klorit behet nga Specialist përkatës që përcaktohen nga Kompania. Pajisja e tyre me dëshmi aftësie kryhet nga komisionet e ngritura

Klorinuesi ka këto detyra kryesore:

1. Për çdo dozim të klorit që kryen mban proces-verbal, duke nënshkruar rregullisht në të.
2. Përpara klorinimit duhet të kontrollojë prurjen e ujit, pajisjet e disifektimit, dozën e caktuar, sasinë e klorit në dhomën e ruajtjes së tij, raportin e % së klorit aktiv etj.
3. Doza që duhet të përdoret për disifektim përdoret prej tij vetëm pasi të jetë dhënë me shkrim nga laboratorit i Kompanisë apo Përgjegjësi i Departamentit.
4. Në qendrën e disifektimit të ujit mbahet libri i të dhënave të punës për prurjen e ujit, dozën e disifektimit, % e klorit aktiv, kohën (grafikun) e klorinimit.
5. Të mbaje të pastër vendin e punës për të mos sjelle asnjë ndotje në depo gjatë procesit të disifektimit.
6. Të mos bëjë dorëzimin e detyrës personave të tjerë që nuk janë të autorizuar nga Kompania dhe nuk janë të pajisur me dëshmi aftësie dhe dëshmi mjekësore.
7. Për çdo rast, përpara përdorimit të disifektuesit (hipokloritit) duhet të bëjë kontrollin edhe në fuçitë e hapura e të përdorura, me anë të Hortolidines, për identitetin dhe cilësinë e tij. Në rast se klorinuesi konstaton fakte të kundërta nga ato që janë shënuar në librin e objektit, është i detyruar të mos e përdorë disifektuesin në atë fuçi dhe urgjentisht duhet të njoftojë eporet për të marrë udhëzime se si duhet të veprojë.
8. Mban dhe evidenton me shkrim klorin mbetës për çdo orë në librin e objektit, duke përdorur etalonët standard, të cilat i ruan me kujdes të madh.
9. Kontrollon me përgjegjësi pastërtinë e ujit (me sy) vazhdimisht. Në rast se konstaton turbullirë uji, së bashku me një nga punonjësit e stacionit, bën nxjerrjen e kësaj sasive uji jashtë tubacionit dhe njëkohësisht njofton eporet për gjendjen dhe mënyrën e veprimit që duhet të bëjë.
10. Nuk lejohet që klorinuesi të ndryshojë grafikun e shërbimit pa dijeninë dhe aprovimin me shkrim të eporit (Përgjegjësit të Departamentit).
11. Nuk lejohet të kryej shërbim në piken e klorinimit (depo apo stacion) pa qene i pajisur me libere shëndetësore të plotësuar periodikisht, siç përcaktohet në rregullat ligjore të dala për këtë qëllim.
12. Të zbatojë në mënyrë të detyrueshme dhe me përpikëri rregullat e sigurimit teknik që janë përcaktuar në detyrën e tij.
13. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, rregullat e caktuara nga Kompania për këtë proces punë dhe në rast shkelje të tyre, mban përgjegjësi disiplinore.
14. Gjatë kohës së punës punonjësit pajisen me bluza të bardha, kapuç, çizme, doreza, maska dhe detyrimisht me libere shëndetësore.
15. Nuk lejohet që pajisjet të çohen në shtëpi me përjashtim të bluzës dhe kapuçit që merren për tu lare.
16. Në vendet e klorinimit ndalohet futja e personave të pa autorizuar dhe pa libere shëndetësore.
17. Marrjen në dorëzim të klorit nga magazina apo personi i caktuar, klorinuesi e bën me dokumentacion të rregullt. Në regjistër shënohet data, sasia, numri i fuçive ose i thasëve, përqindja e klorit aktiv sipas raportit të laboratorit, për çdo fuçi, cisterne ose bombolat si dhe sasia e klorit që duhet të hedh.

18. Përveç detyrave të mësipërme klorinuesi është i detyruar të zbatojë urdhra dhe të kryejë detyra të tjera funksionale që i ngarkohen nga eproret si p.sh. manovrimi i linjave apo depove
19. Manovrimi i linjave apo depove bëhet sipas një grafiku të miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Ujit dhe që shërbejnë për optimizimin e furnizimit me ujë.
20. Moskryerja sipas grafikut e këtyre manovrimeve ngarkon me përgjegjësi personat e caktuar me këtë detyrë.
21. Regjistron të gjitha veprimet në 'fletën e punës' së bashku me kohën e realizimit dhe materialet e përdorura.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendshme:**

## **LEXUESIT E UJËMATËSAVE**

Lexuesit e ujëmatësve do të raportojnë Zyrtarit Shërbimeve të Konsumatorit (Zyrtar SHK) të njësisë operative (NJO).

Ai/Ajo është përgjegjës për marrëdhënie me konsumatorin dhe funksionon si ndërlidhje shumë e rëndësishme për konsumatorin.

Lexuesit e ujëmatësve I raportojnë menaxherit respektiv të Njësisë Operative rreth çështjeve disiplinore sikur:

- Raportimi në punë
- Përpikëria në orar (ardhje -shkuarje)

Sa I përket pushimit Lexuesve të ujëmatësve së pari ju nevojitet aprovimi nga kryesuesi I departamentit dhe në fund nga menaxheri I NJO.

**Detyrat e Lexuesve të Ujëmatësve janë:**

- Leximi me kohë dhe korrekt I të gjithë ujëmatësve në zonën ku ai/ ajo janë alokuar.
- Të jetë I mirë informuar rreth rregulloreve dhe çështjeve sa I përket furnizimit me ujë në zonën respektive.
- Raporton çdo çregullësi.

- Përfaqëson Hidrodrini-n tek konsumatorët dhe publiku dhe kryen detyren e tij/saj në mënyrë të orientuar nga konsumatori.

**Më detajisht kjo përfshin:**

- Lexon saktësisht dhe shënon kuantitetin sikur e indikuar në çdo ujëmatës të çdo konsumatori në zonën e tyre.
- Verifikon leximin faktik të matësit të konsumatorit.
- I heton dhe komenton arsyet për lexime të pazakonta.
- Dorëzon lexime ditore tek Zyrtari SHK në përputhje me orarin.
- Të këtë sqarime sipas kërkesës rreth rasteve të ndryshme.
- Nënshkruan listën e konsumatorëve dhe leximeve respektive.
- Në ekzekutimin e detyrave të lartcekura, Lexuesi I Ujëmatësve duhet gjithashtu të hulumtoj, vëzhgoj dhe raportojë tek Zyrtari SHK për:
- Ndonjë defekt apo dëmtim në instalimin e ujëmatësit.
  - Ndonjë përdorim të dukshëm të ujit të pamatur konsumatorit (kyçja ilegale).
  - Ndonjë keqpërdorim të dukshëm të ujit të furnizuar nga Hidrodrini
  - Çdo rrjedh apo dëmtim të pajisjeve /pronë e Hidrodrinit, përfshirë çdo gjë që mund të ndërhyj në integritetin e sistemit të rrjetit.
    - Të kuptojë kontratën e furnizimit me ujë.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

**Përshkrimi I detyrave Sistemi i Pompave&Mekanizimi.....(3.0)**

Është nomenklature e Departamentit te Operatives, raporton te Menaxheri i Operatives dhe është përgjegjës për detyrat e përditshme te drejtimit dhe punimeve qe kryen Sigurimi dhe Stacioni i Pompave.

Detyrat dhe përgjithësitë:

- Të mbikëqyrë dhe të koordinoj punët ne bashkëpunim me Menaxherin.
- Të cakton rezhimin e pompave ashtu qe te siguroj shtypje normale te furnizimit me ujë gjatë 24h.
- Të organizon mirëmbajtje te pompave dhe te gjitha pajisjeve mekanike.
- Të përcjell shpenzimet si dhe të kontrolloi librat e automjeteve, destinacionet,
- Të raporton për afatet e regjistrimeve te automjeteve dhe për te gjitha pa rregulluesit.
- Është përgjegjës për objektet e Stacionit te Pompimit dhe sigurimin e Objektivit teknik.
- Benë kontrollimin e sigurimit ne objektet e klorinimit Ujii Zi dhe Drini i Bardh si dhe sigurimi i shërbimit Teknik.
- Bene verifikimin e librave te raporteve te sigurimit dhe stacionit te pompimit.
- Raporton drejtpërdrejt tek Menaxheri Operativë si dhe dorëzon raportet mujore.
- Koordinon punët me sektorë tjera te kompanisë.
- Është përgjegjës për disiplinën brenda sektorit.
- Implementon të gjitha detyrat e parashtruara nga Menaxheri Operativ apo nga Drejtori i përgjithshëm.
- Implementon rregulloret për mirëmbajtjen e pompave dhe mekanizimit si dhe rregulloret e sigurisë në punë.

Nën përgjegjësin: Menaxherit Operativë/Drejtorit Menaxhues

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe respekton rregulloret e brendeshme:**

### **Përshkrimi I detyrave për Roje - Sigurim të Objektivit.....(3.3)**

- Të Raporto mbi gjendjen e lenë, gjatë nderimit të tij.
- Të Shënon në librin e ndërmarrjes çdo pa rregullsi dhe
- Të Merre detyrën prej rojës së mëparshme dhe anasjelltas,dhe për çdo parregullsi të shënon në libër, si dhe të Raporton ndonjërin nga Drejtoret.
- Të Pastron oborrin prej letrave dhe duqeve të duhanit, si dhe të zbraz kutin e mbeturinave.
- Të Ndihmoi sipas nevojës, në shkarkim dhe ngarkim rreth depos.
- Në Rast të Avarisë në stacionin e klorinimit të merr masa preventive.
- Të mos flenë në orarin e punës,si dhe të kontrollo të gjitha objektet për rreth.
- Të Mos lejoi hyrjen e personave të pa autorizuar në objekt dhe rreth,si dhe të mos lejoi parkimin e veturave të huaja për rreth objektit.
- Për çfarëdo rasti të rrezikut të informoi menaxherin dhe organet përgjegjëse.
- Sipas nevojës bene ndezjen e ngrohjes dhe gjeneratorit.

#### **Vërejtje:**

- Në çoftëse roja nuk gjendet në vend të punës gjatë orarit të tij automatikisht largohet nga puna, sipas rregullores për të punësuar.
- Për tri pa rregullsi të vlerësuara nga kontrolli e cila behet prej menaxherëve në punë, roja po ashtu largohet nga puna.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

## **Përshkrimi I detyrave për Roje - Sigurim të Objektivit ( Stacionet e Klorinimit).....(3.2)**

- Të Raporto mbi gjendjen e lenë, gjatë nderimit të tij.
- Të Shënon në librin e ndërmarrjes çdo pa rregullsi dhe
- Të Merre detyrën prej rojës së mëparshme dhe anasjelltas,dhe për çdo parregullsi të shënon në libër, si dhe të Raporton ndonjërin nga Drejtoret.
- Të Pastron oborrin prej letrave dhe duqeve të duhanit, si dhe të zbraz kutin e mbeturinave.
- Të Ndihmoi sipas nevojës, në shkarkim dhe ngarkim rreth depos.
- Në Rast të Avarisë në stacionin e klorinimit të merr masa preventive.
- Të klorinoj ujin me sasi te klorit sipas rregullave te marra nga eksperti i klorit.
- Të punoj sipas udhëzuesit për Siguri gjatë nderimit të bombolave.
- Të raportoj me kohë për çfarëdo defekti ne pajisje.
- Të beje leximin e Ujëmatësit të prodhimit ne kohë të caktuar.
- Të mos lejoj personat e pa autorizuar hyrje ne objekte.
- Të mos flenë në orarin e punës,si dhe të kontrolloj të gjitha objektet për rreth.
- Të Mos lejoj hyrjen e personave të pa autorizuar në objekt dhe rreth,si dhe të mos lejoj parkimin e veturave të huaja për rreth objektit.
- Për çfarëdo rasti të rrezikut të informoi menaxherin dhe organet përgjegjëse.

Vërejtje:

- Në çiftëse roja nuk gjendet në vend të punës gjatë orarit të tij automatikisht largohet nga puna, sipas rregullores për të punësuar.
- Për tri pa rregullsi të vlerësuara nga kontrolli e cila behet prej menaxherëve në punë, roja po ashtu largohet nga puna.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe të respekton rregulloret e brendeshme:**

## **POMPISTI / REZHIMI I POMPAVE.....(3.4)**

Pompisti është nomenklature e Departamentit të Ujit, raporton tek Kreu i Departamentit dhe është i angazhuar në punët e përditshme të mirëfunksionimit të stacionit të pompimit.

Pompisti ka për detyre:

1. Te mbaje në gatishmëri dhe te shfrytëzojë sipas rregullave të teknikes stacionin e pompimit.
2. Te marrë dhe të dorëzojë turnin duke shënuar në proces verbal problemet e turnit.
3. Pompisti për vënien në punë të elektropomave bazohet në rregulloren teknike.
4. Te mbaje lidhje me qendrën për probleme që dalin gjatë turnit.
5. Te mos largohet nga turni pa i ardhur ndërruesi i turnit pasardhës. Te lidhet me qendrën për të njoftuar çdo problem.
6. Plotëson rregullisht librin e shfrytëzimit të Stacionit.
7. Zbaton me përpikëri Rregulloren e Sigurimit Teknik në punë.
8. Ka për detyrë të pajiset me librezën e shëndetshis konform rregullave në fuqi, dhe nuk lejohet të kryejë shërbimin në stacion në qoftëse nuk e ka plotësuar atë periodikisht.
9. Bën shërbimin ndaj pompave (kryen grasatimin e kushinetave, karikimin e pompës përpara lëshimit etj.)
10. Zbaton rregullat e disiplinës në punë dhe zbaton urdhrat që i jepen nga eprorët
11. Përveç detyrave të mësipërme mund të kryejë detyra të tjera funksionale që mund t'i ngarkohen nga eprorët si p.sh. manovrimet e valvulave të rrjetit etj.
12. Është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur të makinerive, pajisjeve dhe veglave të Kompanisë.
13. Mirëmban pajisjet e specializuara sipas rekomandimeve të prodhuesit
14. Regjistron të gjitha veprimet në 'fletën e punës' së bashku me kohën e realizimit dhe materialet e përdorura.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendshme:**



## ZYRTARI I SHËRBIMEVE TË KONSUMATORIT

Zyrtari I Shërbimeve të konsumatorit (Zyrtari SHK) I njësisë operative (NJO) I raporton Kryesuesit të Departamentit të Shërbimeve të Konsumatorit për të gjitha çështjet që ndërlidhet me konsumatorë. Ai/Ajo është një ndërlidhje për konsumatorët të NJ.O-së dhe do të për formojë detyrën e tij/saj në mënyrë shumë të orientuar nga konsumatori.

Zyrtari I Shërbimeve të konsumatorit (Zyrtari SHK) I raporton menaxherit respektiv të Njësisë Operative rreth çështjeve disiplinore sikur:

- Raportimi në punë
- Përpikëria ne orar (ardhje -shkuarje)

Sa I përket pushimit Zyrtari I Shërbimeve të konsumatorit (Zyrtari SHK) së pari I nevojitet aprovimi nga kryesuesi I departamentit dhe në fund nga menaxheri I NJO.

**Detyrat e Zyrtarit të Shërbimeve të Konsumatorit të Njësisë Operative janë:**

- Menaxhon dhe monitoron të gjitha shërbimet e ndërlidhura me konsumatorë në NJO
- Menaxhon proceset e leximit, faturimit dhe inkasimit në NJO
- Kontabilitet për tërë paratë e pranuar, në dorë dhe bankë
- Mbikëqyrë Lexuesit e Ujëmatësve dhe Inkasantët

**Më detajisht kjo përfshin:**

- Printon faturat mujore në kohë dhe organizon shpërndarjen e tyre nga inkasantët.
- Organizon dhe mbikëqyrë operimet ditore të lexuesve te ujëmatësve dhe inkasantëve.
- Ndërmerr “kontroll të leximeve” sipas nevojës.
- Heton problemet e matjeve që janë të pa përgjegjura nga lexuesit e ujëmatësve.

- Pranon shumen e mbledhur nga secili inkasant, konton tërë keshin e pranuar në baza ditore, dhe e pagon në xhirollogari bankare siç e udhëzuar nga Kryesuesi I Departamentit SHK.
- Freskon bazën e të dhënave çdo ditë me pagesat e bëra, konsumatorët e ri, çdo ndryshim I raportuar dhe të I dërgon bazën e të dhënave të freskuar në Zyrën Rajonale të Shërbimeve të Konsumatorit në baza të rregullta në marrëveshje me Kryesuesin e Departamentit SHK.
- Propozon dhe implementon përmirësime në leximin e ujëmatësve, faturim dhe inkasim në pajtim me Kryesuesin e Departamentit SHK.
- Raporton te Kryesuesi I Departamentit SHK për ndonjë problem të pazgjedhur të raportuar nga Lexuesit e Ujëmatësve.
- Pranon dhe trajton ankesat e konsumatorëve dhe raporton çështjet e pazgjedhura tek Kryesuesi I Departamentit SHK.
- Pranon dhe përcjell aplikacionet për kyçe të reja tek Kryesuesi I Departamentit SHK.
- Organizon lëshimin e kontratave për konsumatorët e ri.
- Pranon pagesat kesh të faturave nga konsumatorët në zyre.
- Raporton te Kryesuesi I departamentit te SHK në baza të rregullta dhe sipas kërkesës.
- Merret me çdo çështje tjetër të ndërlidhur me shërbime ne NJO përkatëse.
- Propozon Kryesuesit të Departamentit SHK masa adekuate për çdo problem që nuk mundet të zgjidhet ne NJO.
- Kryen çdo detyrë tjetër të dhënë nga Kryesuesi I Departamentit SHK.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

## **ELEKTRICISTI / MEKANIKU.....(3.1)**

Elektriciستی/mekaniku është ne nomenklaturën e Departamentit te prodhimit te ujit, raporton tek Kreu i Operativës dhe angazhohet me punët e përditshme te mirëmbajtjes brenda zonës te aktivitetit te Kompanisë, kryesisht me sistemet elektrike dhe mekanike te stacioneve te pompimit, mjeteve dhe makinerive etj.

Detyrat e elektricistit/mekanikut janë:

1. Te kryeje detyrat e përditshme te mirëmbajtjes për te gjitha llojet e makinerive dhe pajisjeve (elektrike apo mekanike siç kërkohet) sipas programeve te mirëmbajtjes.
2. Kryen riparimin ose zëvendësimin e makinerive dhe pajisjeve (elektrike apo mekanike) sipas udhëzimeve.
3. Te gjitha detyrat duhet te jene ne përputhje me rregulloret teknike dhe sipas rekomandimeve te prodhuesve te makinerive dhe pajisjeve.
4. Harton programin e mirëmbajtjes se planifikuar te makinerive dhe pajisjeve dhe ia dorëzon Menaxherit Operativë
5. Regjistron te gjitha veprimet ne 'fletën e punës' se bashku me kohen e realizimit dhe materialet e përdorura.
6. Kontrollon nivelin e vajit te transformatorëve.
7. Elektriciستی kontrollon punën e elektromotorëve dhe vlerat e rrymave, temperaturën e kushinetave.
8. Kane te drejte:
  - a) Ndërprerjen e punës për pajisjet qe janë jashtë rregullave te sigurimit teknik.
  - b) Te lëne shënimet përkatëse ne librin e Stacioneve
  - c) Te ushtrojnë kontroll ne stacionet e pompimit lidhur me zbatimin e rregullave teknike dhe i propozojnë Kreut te Departamentit masa disiplinore për shkeljet e konstatuara.
9. Tërheq ose kthen materiale nga magazina duke përdorur dokumentacionin e nevojshëm te firmosur nga Menaxheri Operativë.
10. Mirëmban pajisjet e specializuara sipas rekomandimeve te prodhuesit
11. Mban vendin e punës te pastër dhe te rregullt.
12. Është përgjegjës për disiplinën ne pune bazuar ne kodin e punës, dhe është përgjegjës për sigurinë e punëtoreve dhe publikut.
13. Është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur te makinerive, pajisjeve dhe veglave te Kompanisë.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendeshme:**

## INKASANTËT

Inkasantët I raportojnë Oficerit (Zyrtarit) për Shërbime të Konsumatorit (SHK – Zyrtar) të Njesisë Operative. Ai/Ajo është përgjegjës për marrëdhëniet dhe funksionet me konsumatorët si ndërlidhje shumë e rëndësishme për konsumatorin.

Inkasantët I raportojnë menaxherit respektiv të Njesisë Operative rreth çështjeve disiplinore sikur:

- Raportimi në punë
- Përpikëria ne orar (ardhje -shkuarje)

Sa I përket pushimit Inkasantëve së pari ju nevojitet aprovimi nga kryesuesi I departamentit dhe në fund nga menaxheri I NJO.

### **Detyrat e Inkasantit janë të:**

- Të sigurojë mbledhjen e pagesave për ujë të pijshëm dhe kanalizim më kohë dhe korrekt dhe dorëzimin e tyre tek Zyrtari SHK.
- Të jetë I mirë informuar rreth rregulloreve dhe çështjeve përkatëse në zonën respective.
- Të raportojë për çdo parregullsi.
- Të përfaqësoj Hidrodrinin tek konsumatorët dhe te publiku dhe të bejë punen e tij/saj në mënyrë te orientuar nga konsumatori.

### **Më detajisht kjo përfshin:**

- Dorëzimin e faturave të muajit paraprak të prodhuara nga Zyrtari SHK për konsumatorët e zonës së tyre sipas planit.
- Të I sqaroj konsumatorit përmbajtjen e faturës .
- Mbledh pagesat në përputhje me faturat.

- Dorëzohet paratë e mbledhura (inkasuara) te Zyrtari SHK në baza ditore.
- Të këtë sqarime sipas kërkesës rreth rasteve të ndryshme.
- Në ekzekutimin e detyrave të lartcekura , Inkasanti duhet gjithashtu të hulumtoj, vëzhgoj dhe raportojë tek Zyrtari SHK për:
  - Ndonjë përdorim të dukshëm të ujit të pamatur konsumatorit (kyçja ilegale).
  - Ndonjë keqpërdorim të dukshëm të ujit të furnizuar nga Hidrodrini.
  - Çdo rrjedh apo dëmtim të pajisjeve / pronë e Hidrodrinit, përfshirë çdo gjë që mund të ndërhyj në integritetin e sistemit të rrjetit.
- Të kuptojë kontratën e furnizimit me ujë.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**

## **KIMISTI I LABORATORIT**

Laboratori benë pjese ne strukturën e Departamentit te prodhimit te ujit dhe Kimisti i laboratorit është ne varësi direkt te Drejtorit te Departamentit. Laboratori funksionon duke patur si veprimtari te tij analizat fiziko – kimike – baktireologjike te ujit te pijshëm sipas kriterëve te përcaktuara ne "Rregulloren higjeno-sanitare për kontrollin cilësor te ujit te pijshëm", te miratuar me V.K.M. nr.145, date 26.02.1998.

Kimisti raporon tek kreu i Departamentit te Ujit dhe është përgjegjës për analizimin e mostrave te marra nga sistemi i ujit

1. Realizon analizat e plota fiziko-kimike dhe bakteriologjike për te gjitha burimet e furnizimit me ujë (puse dhe burime).
2. Ben analiza periodike ne bashkëpunim me Repartin e Shfrytëzimit, për klorin mbetës ne pikat fundore te saktësuar e miratuara edhe nga Qendra Sanitare
3. Te beje analizimin e mostrave te marra nga sistemi i ujit.
4. Kontrollon, sipas një grafiku te miratuar nga Kreu i Departamentit punën e kryer ne qendrat e klorinimit.
5. Monitoron cilësinë e ujit qe i ofrohet konsumatorëve
6. Ndjek me përgjegjësi dhe merr masat e duhura për zbatimin e rregullave te caktuara ne larjen e depove, duke raportuar për realizimin e kësaj detyre para Kreut te Departamentit, sipas K.T. Higjeno - Sanitar.

7. Jep me shkrim dhe me përgjegjësi dozën e klorinimit të ujit të pijshëm për të gjithë territorin që administron Kompania.
8. I propozon, K/Departamentit të prodhimit të ujit, vendosjen e gjobës apo masave disiplinore personelit klorinues të depove për mos zbatim të rregullave Higjieno – Sanitare të miratuara nga Inspektorati Komunal Shëndetësor.
9. Ndjek me përparësi dhe me analiza konkrete çdo ankese të paraqitur nga banoret që mbulon Kompania, për problemet e cilësisë së ujit të pijshëm, duke raportuar në çdo kohë para K/Departamentit të prodhimit të ujit për realizimin e këtyre ankesave.
10. Siguron që laboratorit mbahet në kushte të përshtatshme.
11. Në bashkëpunim me strukturat e tjera të Departamentit është në krye të punës për zgjidhjen e rasteve të ndotjeve të ujit të pijshëm.
12. Ndjek me përgjegjësi të plote dhe me analiza konkrete laboratorike çdo parti të re të furnizimit me hipoklorit dhe jep raport me shkrim tek K. Degës për përqindjen mesatare të klorit aktiv apo klorit të gazet që përdoret për disinfektim.
13. Përpunon dhe paraqet programe mujore dhe vjetore për Kreun e Departamentit, dhe pas aprovimit menaxhon ekzekutimin e tyre.
14. Mban regjistrime të përditshme të ankesave që lidhen me cilësinë e ujit dhe kontaminimit të tij nga ujërat e zeza si dhe rezultatet e plotë të mostrave të analizuara.
15. Trajton dhe këshillon personelit që merret me detyrën e dozimit.
16. Mirëmban pajisjet e specializuara sipas rekomandimeve të prodhuesit
17. Është përgjegjës për disiplinën në punë bazuar në kodin e punës dhe është përgjegjës për sigurinë e punëtorëve dhe publikut.
18. Është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur të makinerive, pajisjeve dhe veglave të laboratorit.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendshme:**

## **KRYESUESI I DEPARTAMENTIT PËR SHËRBIME TË KONSUMATORIT**

Kryesuesi I Departamentit për Shërbime të Konsumatorit (SHK) do të I raportoj Drejtorit Menaxhues rreth performancës së kompanisë në organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Ai/ Ajo do të dorëzojë raportet te drejtori rreth përparimit në punë dhe rezultatet e aritura gjatë punës me kërkesat e konsumatorëve.

### **Detyrat e Kryesuesit të SHK janë të:**

- Menaxhoj tërë departamentin
- Siguroj komunikimin dhe ndërlidhjen ndërmjet kompanisë dhe publikut (Konsumatorëve).
- Siguroj performancë të mirë të shërbimeve për publikun.
- Siguroj rrjedhën e keshit në ndërmarrje.
- Siguroj komunikimin me të gjitha departamentet tjera.

### **Më detajisht kjo përfshin:**

- Organizon, koordinon dhe monitoron dhe punon në Departamentin SHK.
- Pregaditë dhe ekzekuton planet vjetore/mujore/javore të aktiviteteve të SHK.
- Raporton me gojë dhe me shkrim për rezultatet e punës në Departamentin SHK.
- Monitoron provizionin e shërbimeve të konsumatorit.
- Koordinon punën me sektorët tjerë të kompanisë.
- Siguron nënshkrimin e kontratës në mes të klientit dhe kompanisë.
- Propozon dhe ndërmerr veprime kundër prishjeve të kontratave nga ana e konsumatorit.
- Organizon dhe mbikëqyrë procesin e faturimit.
- Organizon dhe monitoron procesin e inkasimit dhe pregaditë raporte mujore.
- Ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallen e inkasimit.

- Monitoron për se afërmi debitorët (borgjëlënjtë) dhe ri pagesat e tyre.
- Organizon punën e ekipeve të çkyqjes.
- Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhrit.
- Organizon punën e ekipeve të inspektionit, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe serioze.
- Vendos dhe monitoron procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorit / kërkesat / aplikimet.
- Trajton dhe proceson ankesat e konsumatorëve.
- Merret me kërkesat për kyçje të reja, pregaditë dokumentacionin dhe I dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.
- Zhvillon procesin e vetëdijesimit të popullatës.
- Pregaditë dhe ekzekuton anketa të konsumatorëve për të vlerësuar performancën dhe nivelin e kënaqësisë më shërbimet e ofruara.
- Rishikimi I nevojave për trajnim të stafit.
- Monitoron performancën e personelit dhe propozon masa koresponduese.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rrgulloret e brendeshme:**



## MAGAZINIERI

Magazineri është nomenklature e Departamentit të Finance – Administrimit, ka varësi dhe raporton tek Drejtori i Departamentit dhe ka për detyrë administrimin e magazinës së Kompanisë sipas të gjitha rregullave dhe normave ligjore në fuqi

1. Për të gjitha materialet që do bëhen hyrje e dalje në magazine të shoqërohen me dokumentet përkatëse (Flet – hyrje dhe flet-dalje të sakta dhe pa korrigjime).
2. Të mos mbaje në magazine asnjë material të pa shoqëruar me flet-hyrje dhe pa akt-kolaudimi (që mbahet nga grupi i kolaudit ose nga dokumenti përkatës që vërteton cilësinë dhe sasinë e mallit).
3. Të kujdeset për ruajtjen e mirëmbajtjen e materialeve që ka në magazine, duke marrë të gjitha masat e duhura ligjore për mirë administrimin e tyre, konform rregullave të caktuara nga Kompania.
4. Të dorëzojë në Departamentin e Finance – Administrimit të Kompanisë, sa herë që i kërkohet, dokumentet që tregojnë dhe vërtetojnë lëvizjen e materialeve (hyrjen dhe daljen e tyre nga magazina) për çdo fund javë.
5. Të plotësojë sakte dhe pa korrigjime të gjitha dokumentet e lëvizjes së materialeve (flet-hyrje dhe flet-dalje) nga magazina, duke saktësuar dhe çmimet e tyre si dhe çdo kërkesë tjetër ligjore që duhet për magazinim.
6. Të shoqërojë çdo flet-dalje me kërkesën e Departamenteve apo grupeve të punës përkatëse të firmosur nga kreu i Departamentit, Dep. Finance dhe nga personat e tjerë të autorizuar
7. Çdo fillim muaji duhet të bëjë rakordimin midis gjendjes kontabël dhe asaj të kartelës së tij në Degën Ekonomike të Kompanisë.
- 8. Paraqet kërkesa me shkrim, për furnizimin me materiale dhe pajisje siç i nevojiten magazinës dhe ai e konsideron që janë të nevojshme.**
- 9. Mban regjistrime të rregullta të çdo njësie të magazinuar, duke treguar numrin dhe vlerën e mallrave gjendje.**
- 10. I raporton Kreut të Departamentit kur sasinë në magazine arrijnë vlerën e stokut minimal.**
11. Organizon dhe mirëmban artikujt e magazinës në mënyrë të rregullt dhe sistematike.
12. Në rastet e furnizimit të magazinës me baze materiale, të jete në gatishmëri të plote për marrjen e tyre në ruajtje, deri në përfundimin e procedurave për magazinimin e tyre.
13. Të zbatojë me korrektesë disiplinën në punë dhe detyrat e ngarkuara nga Drejtori i Departamentit, duke qenë në gatishmëri për furnizimin me baze materiale të reparteve të Kompanisë për çdo rast emergjent apo për rastet e pa parashikuara.

14. Te mos beje magazinimin e asnjë malli qe nuk përputhet me aktin e kolaudimit te mbajtur nga grupi i kolaudimit te ngrihet me Urdhër te Drejtorit te Shoqërisë , por te njoftoje menjëherë Drejtorin e Departamentit apo Drejtorin e Shoqërisë për problemin qe ka lindur, duke kërkuar saktësimin dhe zgjidhjen e problemit.
15. Përgjigjet materialisht dhe ne rruge disiplinore për çdo shkelje te disiplinës ne pune apo mos realizimin detyre te ngarkuar si dhe për çdo mungese te bazës materiale qe rezulton ne magazine.
16. Te plotësoje me korrektësi kartelat personale te punonjësve te Kompanisë për çdo material qe u behet dalje, duke plotësuar edhe vërtetimet e detyrimeve financiare qe mund te kenë ata me rastin e largimit nga puna, te cilat duhet t'i dorëzoje ne Departamentin e Finance - Administrimit, me rastin e likuidimit te tyre përfundimtar nga Kompania.
17. Respekton rregulloret e brendshme.

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendeshme:**

## **PUNETOR**

(Departamenti i Mirëmbajtjes dhe riparimeve)

Punëtori i departamentit te Mirëmbajtjes është nomenklature e Departamentit te Mirëmbajtjes, raporton te Kreu i Departamentit apo drejtuesit te grupit dhe është përgjegjës për detyrat e përditshme te operimit dhe mirëmbajtjes për rrjetin, ne zonën e aktivitetit te Kompanisë.

Punëtorit normalisht i caktohet te punoje me një skuadër mirëmbajtjeje dhe duhet te jete nen drejtimin e drejtuesit te grupit.

Detyrat e punëtorit janë:

1. Te zbatoje me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën ne pune dhe zbatimin e detyrave te ngarkuara
2. Te mos kundërshtoje dhe zbatoje, brenda kriterëve te caktuara, te gjitha detyrat ditore qe mund ti ngarkohen nga Kreu i Departamentit, brenda profesionit te tij, duke raportuar për realizimin e tyre para eprorit qe i ngarkon këtë detyre konkrete.

3. Te paraqitet ne pune me bazën materiale te furnizuar nga Kompania (veshmbathje dhe vegla pune), duke mbajtur përgjegjësi për çdo shkelje te rregullave te caktuara për këtë qellim.
4. Te zbatoje ne çdo kohe, me korrektësi te plote, rregullat e caktuara për masat e sigurimit teknik ne pune, duke mbajtur përgjegjësi për shkeljen e tyre.
5. Për çdo problem qe mund ti linde gjate zbatimit te detyrës, është i detyruar te njoftoje eprorin qe te japë rruge zgjidhje dhe nuk ka te drejte te mos zbatoje detyrën vetëm për faktin e daljes se problemit. Nuk mund te largohet nga vendi i punës pa realizuar detyrën e ngarkuar pa lejen e Eprorit.
6. Te beje gjermime dhe rimbushje me krahë, kur nevojiten.
7. Te ndihmoje drejtuesin e grupit ne realizimin e detyrave te tij.
8. Te punoje për pastrimin e kanalizimeve te ujerave te zeza me mjete
9. Te punoje për ngritjen, ngarkim-shkarkimin e materialeve etj
10. Te mbaje vendin e punës te pastër dhe te rregullt.
11. Është përgjegjës për disiplinën ne pune bazuar ne kodin e punës dhe kontratat kolektive, dhe është përgjegjës për sigurinë e punëtorëve dhe publikut.
12. Është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e duhur te makinerive, pajisjeve dhe veglave te Kompanisë.
13. Përveç detyrave te mësipërme punëtori kryen edhe detyra te tjera qe mund ti caktohen

*Pika 8 është specifike vetëm për punëtorët e rrjetit te ujerave te zeza.*

**Si dhe detyra tjera, sipas kërkesës së Kompanisë dhe Respekton rregulloret e brendeshme:**

## **SHOFERI.....(2.1)**

Detyrat e shoferit janë te:

1. Te drejtoje mjetin sipas udhëzimeve dhe ne përputhje me rregulloret e trafikut dhe Kodin Rrugor Kosovar dhe rekomandimeve te prodhuesve.
2. Te kujdeset për mirëmbajtjen e mjetit veçanërisht nga pikëpamja teknike
3. Te raportojë çdo defekt apo shërbim qe kryen mjetit tek Përgjegjësën e sektori nga i cili varet.
4. Regjistron te gjitha lëvizjet e kryera si dhe karburantin dhe vajin e përdorur, ne 'ditarin e makinës'.

5. Regjistron te gjitha veprimet ne 'fletën e punës' se bashku me kohen e realizimit dhe materialet e përdorura.
6. Nuk lëviz me automjetin pa urdhër dhe për qëllime personale. Ne rast te kundërt mban përgjegjësi dhe ndaj tij merren masa disiplinore.
